



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:204822  
Datë: 16.12.2019  
Numri i dokumentit: 00735218

**P.nr.987/2019**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i përgjithshëm divizioni penal**, si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtari i vetëm gjykues Adem Shabani me zyrtaren Ligjore Kadishe Shabani, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1582-2/2019 të datës 16.09.2019, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.V, nga Ferizaj, me vendbanim në rrugën ..., nr...., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve në vazhdim e nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, ka mbajtur shqyrtimin fillestar, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, përfaqësuesit të KEDS-it B.S, të akuzuarit F.V, me datë 16.12.2019 të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari F.V, nga Ferizaj, me vendbanim në rrugën ..., nr...., i lindur me datë ..., nga i ati N... ëma R... e vajzërisë H..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i tre fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike, -shfrytëzues, i pa dënuar deri me tani mbrohet në liri, me numër personal ..., -

**ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE:**

**1.** - Me datën 12.04.2019, në rrugën ... nr...., në Ferizaj, në shtëpinë e tij me anë të lajthimit siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohet vetëm me shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla në atë mënyrë që me rastin e kontrollimit nga zyrtaret e KEDS-it , është hasur njehsori elektrik numër ..., ( grupi tarifor 4/02) në lidhje direktet në rrjetin e energjisë elektrike duke anashkaluar njehsorin-matësin e energjisë elektrike, duke shkaktuar kështu të dëmtuarës KEDS-it dëm material në vlerë 37.80 Euro, -

**2.** Me datën 13.05.2019, në rrugën ..., nr...., në Ferizaj, në shtëpinë e tij me anë të lajthimit siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohet vetëm me shkëmbim të kompensimit dhe shmangë pagesën për shërbime të tilla në atë mënyrë që me rastin e kontrollimit nga zyrtaret e KEDS-it , është hasur njehsori elektrik numër ..., ( grupi tarifor 4/02)

në lidhje direkt në rrjetin e energjisë elektrike duke anashkaluar njehsorin-matësin e energjisë elektrike, duke shkaktuar kështu të dëmtuarës KEDS-it dëm material në vlerë 44.36 €uro,-

3. Me datën 12.07.2019, në rrugën ..., nr..., në Ferizaj, në shtëpinë e tij me anë të lajthimit siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohet vetëm me shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbimeve të tilla në atë mënyrë që me rastin e kontrollimit nga zyrtaret e KEDS-it, është hasur njehsori elektrik numër ..., (grupi tarifor 4/02) në lidhje direkt në rrjetin e energjisë elektrike duke anashkaluar njehsorin-matësin e energjisë elektrike, duke shkaktuar kështu të dëmtuarës KEDS-it dëm material në vlerë 101.590 €uro,-

**- me këtë në vazhdim ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.**

Gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe neneve 4, 7, 17, 38, 39, 40, 46, 47, 48, 49, 69 dhe 77 të KPRK-së dhe nen. 365 dhe 543 par.4 të KPPK-së e:

## G J Y K O N

Të akuzuarit **F.V**, i shqipton dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj dhe në të njëjtën kohë urdhëron që dënimet e shqiptuara me burgim të mos ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej 1 /një/ viti pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë nuk do të kryej vepër tjetër penale.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës KEDS-it Distrikti në Ferizaj nga dëmi i shkaktuar në vlerë 183,75 €uro,- t'ia kompensojë në afat prej 15 ditës gna dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I akuzuari, lirohet nga shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe taksës për kompensimin e viktimave të krimit, bazuar në nenin 453 par 4 të KPPRK-së, me që po të obligohet që ti paguaj do të rëndonin gjendjen ekonomike të tij pasi është shfrytëzues i pensionin me aftësi të kufizuara e kjo vërtetohet me Vendimin nr. të dosjes 6004405 i dt.10.10.2018 i lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

## A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën me numër PP.II.nr.1582-2/2019 të datës 16.09.2019, me të cilën ka ngarkuar të akuzuarin F.V, nga Ferizaj, me vendbanim në rrugën ..., nr..., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve në vazhdim e nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPRK-së me datën 16.12.2019, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Avdullah Abedini, përfaqësuesi i KEDS-it B.S dhe i akuzuari F.V.

Në fillim të shqyrtimit fillestar gjyqtari bazuar në nenin 245 par 2 të KPPRK-së ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në vazhdim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPRK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarit janë respektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, duke vepruar sipas nenit 246 par 4 të KPPRK-së, i ka ofruar mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari F.V, në shqyrtimin fillestar ka për veprën penale që akuzohet ka deklaruar se e ndien vetën fajtorë dhe e pranon fajësinë si në pikat e diapozitivit të aktakuzës dhe është e vërtetë se në rrjeti elektrik është kyçur pa lejen punëtorëve të KEDS-it, duke e anashkaluar njësinë matëse, por këtë e ka bërë për shkak të gjendjes jo të mirë materiale si dhe gjendjes jo të mirë shëndetësore e në veçanti nuk ka mundur që të lehtësojë fëmijët pa rrym pasi që janë të moshës së vegjël. Është e vërtetë se i kanë ardhur punëtorët e KEDS-it dhe me kanë kanë hequr vërejtje që të shkyçem nga rrjeti dhe të lidhem në njësinë elektrik, por kushte të ekonomike siç e cekta edhe me larat janë të papërbalueshëm, ku për këtë kam shkuar edhe në KEDS dhe kam bërë kërkesë që të më lirojnë nga pagesa por deri me tani nuk më kanë marruar përsyshë. ku të vetmin burim të ardhurave që merr ka vetëm pensionin me aftësi të kufizuara, dhe i ofroj gjykatës vendimin që merre pension të personave me aftësi të kufizuara, është baba i tre fëmijëve i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal të marr për bazë theksimet e cekura dhe të shqiptoj një dënim më të lehtë.

Gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPRK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPRK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit Avdulla Abedini, ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajësisë është bërë konform ligjit dhe pranimi korrespondon edhe me provat materiale që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale dhe kërkon nga gjykata që të njëjtin ta pranojë si të tillë.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vetëtuar se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështetur në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale dhe atë: procesverbalin me numër 2478578 i datës 29.03.2019, fatura DFEHP1916584 i datës 03.04.2019, kalkulimi RH datës 03.04.2019 fotografitë e vendit të ngjarjes dhe provat të tjera që gjenden në shkresat e lëndës.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve në vazhdim e nga neni 314 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, i gjendjes jo të mire ekonomike ku të vetmin burim të ardhurave që merr ka vetëm pensionin me aftësi të kufizuara, i gjendjes jo të mire shëndetësore, është baba i tre fëmije, dhe pranon se nuk ka mundur të mbesë pa furnizim të energjisë elektrike, ka premtuar se më nuk do të përsërisë veprime të tilla, mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmërinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre theksimeve i shqipton dënimin si në diapozitiv të këtij aktgjykimit duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata në mbështetje të nenit 463 par.1 të KPPRK-së ka obliguar të akuzuarin që të dëmtuarës KEDS-it Distrikti në Ferizaj t' a paguaj dëmin që e ka shkaktuar të precizuar në diapozitiv të aktgjykimit.

Vendimi për lirim nga pagesa e paushallit gjyqësor dhe taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marr në kuptim të dispozitës së nenit 453 par.4 të KPPRK-së.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,  
**P.nr.987/19 me datë 16.12.2019**

**Zyrtare ligjore**  
Kadishe Shabani

**Gjyqtari**  
Adem Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.